

POLICIA

Përmirësim në:

- implementimin e Strategjisë 2017-2021 të Policisë së Kosovës (PK) për Policinë në Komunitet dhe plani i veprimit ku 18 nga 20 veprime të PK-së janë kryer.
- qëndrueshmërinë dhe llogaridhënien e PK-së
- kapacitetin hetimor të PK-së në rastet e dhunës në baza gjinore

Njësitë e specializuara të PK-së po i afrohen standardit operacioal të shteteve homologe të BE-së Arritja e përfaqësimit të balancuar etnik dhe gjinor, si dhe sigurimi i fondeve shtesë për pajisje dhe automjete mbetet sfidë.

Rruga përpara: Me mandatin e ri, EULEX-i ka tërhequr mbështetjen e tij këshillëdhënëse për Policinë. Prandaj, zyra e BE-së do të vazhdojë të mbështesë menaxhmentin e lartë të PK-së me një rol këshillëdhënës më të kufizuar.

DOGANA DHE POLICIA KUFITARE

Krahasuar me 2016:

- mbledhja e të hyrave për vitin 2017 është rritur për 7% (70 milion €)
- aksionet kundër lojërave të fatit të kundërligjshme janë rritur për 67%
- aksionet kundër kontrabandës janë rritur për 65%, përfshirë:
 - 38 raste të konfiskimit të armëve dhe municionit
 - 54 raste të konfiskimit të narkotikëve
 - konfiskimin e valutave të falsifikuara me vlerë prej më shumë se 2 milion €.
- rezultatet në luftën kundër mallrave të falsifikuara janë rritur mbi 100%

Rruga përpara: Me mandatin e ri, EULEX-i do t'i këshillojë Doganat e Kosovës dhe Policinë Kufitare në avancimin e zbatimit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (IBM), Marrëveshjen e Dialogut dhe dokumentet që lidhen me to.

DREJTËSIA

- **EULEX-i** ka monitoruar 200 lëndët e transferuara më parë tek homologët vendas;
- **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK):** Shkalla e lëndëve të kryera është rritur me 145% kah fundi i vitit 2017, gjersa numri i lëndëve të vjetra të pazgjidhura është zvogëluar në 38.79% në gjysmën e parë të vitit 2018, krahasuar me 62.26% në vitin 2017
- **Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK):** numri i lëndëve të zgjidhura është rritur, 7.92% të lëndëve në vitin 2017 janë zgjidhur përmes ndërmjetësimit, krahasuar me 5.29% në vitin 2016, gjersa në gjysmën e parë të vitit 2018, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur deri në 11.18% të lëndëve përmes ndërmjetësimit
- 2,070 e lëndëve janë zgjidhur nga **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS)** gjë që është në përputhje me shkallën e tyre në vitet e mëparshme – prej korrikut 2016 deri në qershor 2017, DHPGJS-ja ka zgjidhur 2,182 lëndë
- 111 lëndë janë mbyllur nga **Kolegji i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP)**, krahasuar me 160 lëndë të mbyllura prej korrikut 2016 deri në qershor 2017
- **Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK):** shenja modeste drejt standardeve të BE-së, me njëfarë progres, ndonëse të përzier, në rekrutimin e stafit, si dhe në organizimin e objekteve të SHKK-së

Rruga përpara: në mandatin e ri, EULEX-i do të vazhdojë t'i monitorojë DHPGJS-në, Kolegjin e Apelit të AKP-së si dhe rastet e përzgjedhura të profilit të lartë që Misioni i ka dorëzuar tek homologët vendorë. EULEX-i më nuk do ta këshillojë KGJK-në dhe KPK-në, gjë që do të mbështetet nga Zyra e BE-së. Megjithatë, EULEX-i do të vazhdojë të bëjë mentorimin dhe këshillimin e menaxhmentit të lartë të SHKK.

- IML-ja ka kryer tetë zhvarrime në Kosovë dhe një në Shqipëri, ku ka identifikuar 10 individë dhe u ka dorëzuar mbetjet mortore të nëntë personave të pagjetur familjeve të tyre

Që nga krijimi i tij, IML-ja:

- ka lehtësuar kthimin e mbetjeve trupore të 506 personave të pagjetur te familjet në Kosovë
- ka kryer 595 operacione në terren dhe 430 identifikime – 300 nga të cilat ishin persona të pagjetur
- ka lehtësuar analizën e 2,261 mostrave të ADN-së

Rruga përpara: ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it do të mbeten në dispozicion për ta mbështetur institutin me kërkesë të autoriteteve vendore. Përveç tjerash, një projekt IPA i nisur në shkurt të vitit 2018 ka për synim fuqizimin e kapacitetit të IML-së për një periudhë prej 36 muaj.

- Integrimi i drejtësisë: 40 gjyqtarë serb të Kosovës dhe 13 prokurorë serbë të Kosovës janë integruar në gjyqësorin e Kosovës
- Progres i ngadalshëm në zbatimin e marrëveshjeve të lehtësuara nga BE-ja në lëmin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (IBM), regjistrim civil dhe liri të lëvizjes

Rruga përpara: në mandatin e ri, EULEX-i do të vazhdojë të mentorojë dhe këshillojë palët në lidhje me zbatimin teknik të marrëveshjeve të BE-së që ndërlidhen me IBM-in dhe lirinë e lëvizjes, ndërsa do të shkojë duke e zvogëluar mbështetjen e vet për Agjencinë e Regjistrimit Civil. EULEX-i po ashtu do të ofrojë mbështetje të mëtejme për integrimin e drejtësisë në veri të Kosovës.

